



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. ____, datë ____ 2022

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM NR. 360, DATË 29.4.2015 “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË NDOTËSVE ORGANIKË TË QËNDRUESHËM DHE
PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR PRODHIMIN, IMPORTIMIN, VENDOSJEN NË TREG
DHE PËRDORIMIN E TYRE”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 30, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 360, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 4, të Kreut I, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1.1 . Shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” ndryshojnë me përmbajtje si vijon: :

“a) **“Vendosje në treg”**, ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të Ligjit 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;

“b) **“Artikull”**, ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të Ligjit 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;

“c) **“Përzierje”**, ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të Ligjit 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;

“ç). **“Stok”**, është substancat, përzierjet ose artikujt e grumbulluar nga mbajtësi i stokut që përbëhen ose përmbajnë ndonjë prej substancave të renditura në Aneksin I.

1.2 . Pas shkronjës “ë” të pikës 4, shtohen përkufizimet me përmbajtje si vijon:

“f). **“Import”**, ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të Ligjit 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;

“g). **“Prodhim”**, ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të Ligjit 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;

menaxhimin e kimikateve”;

- “i). **“Substancë”**, ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të Ligjit 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;
- “j). **“E ndërmjetme në sisteme të mbyllura me sipërfaqe të kufizuar”**, është një substancë që prodhohet, konsumohet ose përdoret për përpunim kimik për t’u transformuar në një substancë tjetër (“sintezë”), ku prodhimi i substancës së ndërmjetme dhe sinteza e një ose më shumë substancave nga ajo substancë e ndërmjetme ndodh në të njëjtin vend, nga një ose më shumë subjekte, në kushte rreptësisht të kontrolluara, në mënyrë që të përmbahet në mënyrë rigoroze me mjete teknike gjatë të gjithë ciklit të jetës”;
- “k).”**Ndotës gjurmë i paqëllimshëm**”, është niveli i një substance që gjendet rastësisht i pranishëm në një sasi minimale, e cila nëse gjendet nën këtë sasi minimale nuk mund të përdoret në mënyrë kuptimplotë, dhe mbi limitet e gjurmimit të metodave ekzistuese të gjurmimit që mundësojnë kontrollin dhe zbatimin;

2. Anekset I, II, III dhe IV, të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” të pikës 3 të kreut I, zëvendësohen me Anekset I, II, III dhe IV, bashkëlidhur këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
3. Kudo në përmbajtjen e vendimit 360/2015, togfjalëshi “*Ministria e Mjedisit*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*Ministria përgjegjëse për mjedisin*” si dhe togfjalëshi “*Inspektoriati shtetëror i mjedisit dhe pyjeve*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*struktura përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin në fushën e mjedisit*”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 Dhjetor 2022.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA